



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.5.2023

Nr: 67

Ora: 18:00

U R D H Ë R

PËR

**DORËZIMIN E PAJISJES SË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE (PEI), DHE TË  
KAMERËS SË PËR VIDEO RREGJISTRIM NË QENDRËN E VOTIMIT,  
PËR ZGJEDHJET E DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

U R D H Ë R O J M Ë:

1. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) duhet t’i dorëzojë KQV-së përkatëse, pajisjen e identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), si dhe kameran që do të vendoset në qendrën e votimit.
2. Operatori duhet të paraqitet në qendrën e votimit ku është caktuar nga KQZ-ja, në orën 06:00 të datës 14 Maj, 2023.
3. Në rast se operatori nuk paraqitet në qendrën e votimit në orën e përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri, sekretari i KQV-së, në prani të kryetarit/zëvendëskryetarit vendos në punë kameran sipas udhëzimeve teknike që gjenden në këtë pajisje, si dhe e pozicionon atë sipas udhëzimeve të KQZ-së.
4. Në rast se operatori nuk paraqitet në qendrën e votimit ku është caktuar nga KQZ-ja, atwhere në këtë rast identifikimi i zgjedhësit bëhet me listën e printuar të zgjedhësve të dërguar nga KZAZ-ja.
5. Paraqitja e operatorit pasi ka filluar votimi nuk e ndërpret për votimin e filluar dhe në këtë rast operatori nuk mund ta përdor PEI-n.
6. Në rast të mungesës së operatorit asnjë prej anëtarëve të KQV, përfshirë kryetarin/zëvendëskryetarin dhe sekretarin, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk kanë të drejtë të përdorin PEI-n. Në rastin kur PEI nuk është përdorur, ai dorëzohet pas mbylljes së procesit të votimit nga KQV-ja tek KZAZ-ja përkatëse.

Data: 12.5.2023 Nr.67  
Ora:18:00



“Për dorëzimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), dhe të kamerës së për video regjistrim në qendrën e votimit, për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023”

7. Ngarkohen KZAZ-të, KQV-të dhe operatorët teknik për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Lealba PELINKU**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 12.5.2023 Nr.67  
Ora:18:00



Për dorëzimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), dhe të kamerës së për video regjistrim në qendrën e votimit, për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023”